

KAPITULLI DYMBEDHJETE

KONKLuzion: PO ME PAS?

12.1 HYRJE

Ky raport ka debatuar rreth disa temave dhe ka propozuar gjashtedhjeteshtate projekte qe kane mbuluar ato tema. Ky kapitull i fundit pyet: cfar e duhet te behet me pas? Cilat jane veprimet kyçe qe duhen ndermarre ne vitet e ardhshme, dhe si duhen lidhur ata sebashku si pjese e teresise sinergjike?

Kemi pergatitur nje 'katalog' prej dhjete projektesh te cilat mund te paraqiten ne nje konference Donator/Autoritet Qeveritar, ne menyre qe te perpilohet nje Plan Veprimi per pese vitet e ardhshme, dhe te bihet dakord mbi paketen e financimit. Ky dokument i shkurter eshte i publikuar vecmas.

Gjithsesi, ketu po permbledhim thelbin e propozimit, dhe kerkojme te tregojme koherencen e tij konceptuale. Por kuptojme qe realiteti do te dale nga konferenca e parashikuar, (e cila kuptohet qe nuk duhet te jete nje ngjarje unike por nje proces rishikimi i herepashershem dhe i vazhdueshem).

12.2 LOGJIKA E PERGJITHSHME

12.2.1 Idea Qendrore: Marrja e Kontrollit mbi Token

Sipas kendveshtrimit tone, çelësi i progresit te pergjithshem eshte planifikimi dhe menaxhimi i zhvillimit dhe perdorimit te tokes (ne Pjesen 12.3 me poshte, u jemi referuar veprimeve A, B dhe G ne lidhje me kete). Deshtimi ne realizimin e kesaj sjell deshtime te tjera (dhe suksesi i ketushem do te ishte çelësi i progresit ne shume fusha te tjera).

- *Zhvillimi Ekonomik*

Nevoja e pare e investitoreve eshte hapësira. Mungesa e tregut do te thote qe ata nuk mund te percaktojne vleren e asetëve apo te vleresojne mundesine e nje investimi. Nese rajoni deshton ne dhenien e tokes investitoreve (e ne fakt keshu eshte), atehere deshton – pike. Nese çdokush mund te perdore çfaredolloj toke qe ka deshire te perdore per cilindo qellim, atehere nuk do te kete kushte tregu, çmim apo vlere te parashikueshme aseti.

Ne zonat rurale, fragmentimi i pronave te tokave ndalon agrikulturen se qeni nje biznes frytdhenes.

- *Ambjenti*
Shkaku kryesor i nje ambjenti te degraduar eshte zhvillimi i rastesishem i cili (a) pushton zonat e mbrojtura dhe (b) ndot ujerat mbitokesore dhe nentokesore nga pusët e pakontrolluara. Pergjigjet jane (a) kontrolli i zhvillimit dhe (b) rritja e planifikuar urbane deri ne densitete ku infrastruktura eshte teknikisht dhe ekonomikisht e mundshme.
- *Infrastruktura*
Te gjitha organizatat e sherbimeve komunale kane nevoje te dine se ku do te ndertohet dhe ku do te jene "Te Drejtat Publike te Rrugeve". Kjo kerkon planifikim dhe kufizim, ne densitete qe kane kuptim ekonomik. Mungesa e infrastruktures ka nje efekt kritik rrezues duke shkaterruar ambjentin dhe larguar investitor et.

12.2.2 Tri Ide te Tjera ne Lidhje me kete.

Çeshtja e tokes shihet si nje çeshtje themelore (veprimet A, B dhe G). Çeshtja e dyte eshte sigurimi i sherbimeve (veprimet C, D, E dhe F), te cilat do te financohen perfundimisht nga vlera e tokes dhe do te koordinohen ne hapësire. Toka nuk mund te ndahet nga sherbimet komunale.

Idea e trete ka te beje me kundershtrimin e efektit demtues nga periferizmi dhe me promovimin e nje *ekuilibri* ndermjet qytetit dhe fshatit. Popullsia do te levize drejt qyteteve dhe kjo mund te thelloje krizen rurale dhe te shkaktoje nje neglizhim te kontributit te mundshem te zonave te thella: shih veprimin H.

Se fundmi, veprimet e permendura ketu perfshijne edhe rritjen e kapacitetit te te dy sektoreve, publik dhe privat, nese ata do te kene sukses: (shih veprimet I dhe J).

12.3 DHJETE PROPOZIME TE MENJEHERSHME VEPRIMI

(A) *Shpermdarja e Trojeve per Ndertimin e Shtepive me Sherbime te Kryera ne Zonat e caktuara te Zhvillimit Urban*

Numrat e Projekteve: E-1 deri E-7. Justifikimi i Fazes 1: ky veprim do te (a) lehtesonte levizjen e popullsise ne nenrajonet urbane nga ato rurale; (b) kontrollonte ndikimin e urbanizimit te parregullt mbi ambjentin;

(B) *Shpermdarja e Tokave te Biznesit me Sherbime te Kryera ne Zonat e caktuara te Sherbimit Urban*

Numrat e Projekteve: Econ-6.
Justifikimi i Fazes 1: ky veprim do të (a) lehtësonte krijimin e ndërmarrjeve dhe punësimit përmes rritjes së tërheqjes të investitoreve në rajon; (b) kontrollojë ndikimin e kesaj mbi ambientin;

(C) Projekte të Rrugeve Strategjike

Numrat e Projekteve: R-1 (Tangencialja në Perëndim të Shkodrës) R-7/8/9 (lidhja Velipojë, Bushat, Vau i Dejës) R-22 (Tangencialja në Jug të Lezhës).
Justifikimi: ky veprim do të integronë token e biznesit dhe të ndërtimit të shtëpive në fazën e parë (të propozuar me lart) në strukturën ekonomike rajonale, veçanërisht 'PodShkod'. Projekti i rrugës Shkoder-Hani i Hotit është tashmë i financuar e kështu nuk përfshihet në këtë listë. Elemente të tjera të Programit të Rrugeve Strategjike, si Ura e Bunës dhe Korridori i Kosovës, parashikohen në Fazën 2;

(D) Projekte Strategjike për Ujin

Numrat e Projekteve: I-1 deri I-5.
Justifikimi i Fazes 1: ky veprim do të integronë fazën e parë të tokave të biznesit dhe ndërtimit të shtëpive në sistemet përsore dhe dytesore të menaxhimit dhe furnizimit të burimeve ujore rajonale. Inisiativat e shpërndarjes së tokave me shërbime të kryera (shih me lart) do të sigurojnë shpërndarjen e ujit tretësor brenda 'Zonave të Zhvillimit Urban', por do të jetë e nevojshme që këto të lidhen me sistemet strategjike;

(E) Projekte Strategjike për Kanalizimet: Faza 1

Projektet I-7 deri I-11. Justifikimi për Fazën 1: projektet mbi token do të gjenerojnë sasi domethënëse kanalizimesh që kërkojnë trajtim dhe venie në përdorim, patjetër;

(F) Vende Higjienike për Mbushjen e Tokës dhe Mjetet për Mbeturinën e Ngurta

Numri i Projektit: E-3. Justifikimi i Fazes 1: deshtimi në dispozimin e mbeturinave të ngurta është një pengesë mjaft serioze për tërheqjen e

investimeve të brendshme si edhe një kercenim ambiental. Toka për biznese apo ndërtim banesash kërkon një sistem hedhjeje mbeturinash të ngurta po aq sa dhe rrugët strategjike dhe infrastruktura.

(G) Programi i Konsolidimit të Tokës Agrikulturore

Numri i Projektit: Econ-1. Justifikimi i Fazes 1: kjo do të mbledhë token në ferma ekonomisht me frytëdhënëse. Ky është një parakusht për ringjalljen e agrikultures dhe agribiznesit, të cilat në i shohim si themeli kryesor për ringjalljen e ekonomisë në përgjithësi;

(H) Projekti për Zhvillimin e Zonave të Thella

Numri i Projektit: RD-1 deri RD-6.
Justifikimi i Fazes 1: plani parashikon transferimin e një pjese të popullsisë nga zonat e thella në 'PodShkod'. Por kjo rrezikon një thellim të spirales së rënies në zonat e thella dhe humbja e çdo ekuilibri koherent urban-rural. Është e nevojshme të përforcohet çështja social-ekonomike e jetës në zonat e thella në lidhje me rrugët rurale, nyjet ekonomike dhe infrastrukturën sociale të bashkësisë;

(I) Përforcimi i Institucioneve për Zhvillimin Ekonomik

Numri i Projektit: Econ-2 dhe 3.
Justifikimi: organizimi dhe kapaciteti i sektorit privat ka nevojë të zhvillohet shumë më tej nëse do të luajë një rol të dobishëm përmes energjive dhe aftësive për zhvillimin e ndërmarrjeve. Kjo përfshin trajnimin e biznesit dhe përqendrimin në kapitalin e rrezikut.

(J) Krijimi i Institucioneve për Zhvillimin në Zonat e Zhvillimit Urban dhe Përgatitja e Planeve Lokale

Numri i Procesit: H-9 dhe E-2.
Justifikimi: ky projekt do të caktojë efektshmërinë e ndonjë institucioni dhe procesi në sektorin publik apo 'interesin publik', si konsorciumet e pronesisë së tokave dhe trustet e zhvillimit. Kjo do të sigurojë përgatitjen e 'Planeve Lokale' dhe dokumentacionit kontraktual të ndërtimit në lidhje me to.

12.4 KONKLUZION

12.4.1 Totali i Buxhetit

Vlerat e buxhetit per keto dhjete projekte te paraqitura me lart arrijne ne nje shume totale te perafert prej Euro 60 milion (ose nje mesatare vjetore prej Euro 12 milion).

12.4.2 Nje Konference Donator – Autoritet Qeveritar

Detyra e pare eshte realizimi i nje konference per te konfirmuar zgjedhjen e projekteve per veprimin ne fazen e pare dhe me pas pergatitja e nje pakti se kush do te jene financuesit.

Kjo nuk duhet te jete nje ngjarje e vetme, por me teper nje ngjarje qe perseritet, qe do te lejonte skuadrat e financuesve dhe promovuesve te integrojne perpjekjet e tyre vit pas viti. Si themel te konferences, konsulentet kane pergatitur nje katalog pershkruar te te dhjete projekteve qe permenden ketu, si edhe nje shfaqje dhe fletushke per informimin e publikut.

12.4.3 Perkushtimi dhe Entuziazmi

Asnje prej ketyre propozimeve nuk do te funksionojne pa nje perkushtim te madh nga drejtuesit politike dhe levizje profesionale vullnetare. Ka shume pak interes ne planifikimin dhe menaxhimin e aspekteve hapesinore te procesit te zhvillimit, (edhe pse ekonomia e tokave apo 'ekonomia-hapesinore' eshte po aq e rendesishme sa kapitali dhe krahu i punes ne lehtesimin e procesit te zhvillimit). Ky dizangazhim personal dhe politik eshte rreziku i vertete, qe duke e krahasuar me mungesen e 'ekspertizes' kjo e fundit eshte nje veshitresi e vogel dhe e pertypshme.